



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA VLORË**  
**DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vlorë, më \_\_\_\_\_ 2020

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2020

**PËR**  
**DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR**  
**PËR MUAJIN MARS 2020**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika 1/1 a dhe 1/1 b, nenin 21 të Ligjit Nr.57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 1 të Kreut IV të Vendimit Nr.957, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe fondit të kushtëzuar”, si dhe VKB Nr.4, datë 30.01.2020, “ Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondet e buxhetit Vendor”, për familjet që nuk i plotësojnë të gjitha kriteret për dhënie të ndihmës ekonomike, si dhe në bazë të materialit të paraqitur nga Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social për Këshillin e Bashkisë

**V E N D O S A:**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Mars 2020 gjithsej 10 familje me një fond prej 23.696 (njëzetë e tre mij e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.
2. Familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuar sipas njësive janë:

Nr	Njësitë administrative	NDIHMË EKONOMIKE	
		nr	lekë
1	Qendra e Bashkisë Vlorë	10	23.696
<b>GJITHËSEJ</b>		<b>10</b>	<b>23696</b>

3. Familjet përfituese janë në listën emërore bashkëlidhur materialit .
4. Masa e pagesës për familjet përfituese përlogaritet sipas V.K.M nr. 957, datë 04.09.2019 “Per përcaktimin e kriterëve,të procedurave,dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” pika 1,kreu IV .
5. Ndhma ekonomike të fillojë në datën 01.03.2020 dhe pagesa të bëhet mbas datës 30.04. 2020.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social .
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1/1 a dhe 1/1 b .

**K R Y E T A R I**

**Dritan Leli**

